

V E N D I M
Nr. 616, datë 4.12.2002

**PËR PËRCAKTIMIN E KATEGORIVE TË TJERA TË GRUPEVE TË VEÇANTA QË
PËRFITOJNË NGA LIGJI NR. 8872, DATË 29.3.2002 "PËR ARSIMIN DHE FORMIMIN
PROFESIONAL NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe nenit 5 të ligjit nr. 8872, datë 29.3.2002 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë ", me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës dhe të Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Grupe të veçanta, që përfitojnë nga ligji nr. 8872, datë 29.3.2002, përveç atyre të përcaktuara në nenin 5 të ligjit janë edhe:

- a) personat që përfitojnë nga programet e mbështetjes me të ardhura;
- b) personat që dalin të papunë nga ndërmarrjet dhe institucionet në proces reformimi, ristrukturimi dhe privatizimi;
- c) vajzat, nëna, të papuna;
- ç) vajzat dhe gratë e trafikuar;
- d) gratë e divorcuara, me probleme sociale;
- dh) personat që kthehen nga emigracioni me probleme ekonomike;
- e) të sapodiplomuarit, të paorientuar në tregun e punës;
- ë) personat që kanë vuajtur dënimin me burgim.

2. Ngarkohen Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale dhe Ministria e Arsimit dhe e Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano